

## Europa League/ Mediat turke “kualifikojne” Kukesin ne grupe

nga AlbaniaSoccer

E diel, 01 Shtator 2013 14:12

---



Ne mediat turke eshte perhapur lajmi se skuadra e Trabzonsporit do te skualifikohet nga UEFA. Tre vite me pare, turqit mendohet te jene perfshire ne trukim rezultatesh dhe kjo mund ti jape nje penalitet. Ne kampin kuksian presin zyrtarizimin e lajmit qe mund ti dergoj ne grupet e Europa Leagues. Tifozet jane perfshire nga entuziazmi dhe shpresojne qe endrra tu behet realitet. Megjithate UEFA ende nuk e ka dhene versionin perfundimtar per kete histori.